



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbali i përgjithshëm për mbajtjen e 9 dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Përmbajtja:

- Tabelori me të dhëna të shkurtëra për dëgjime buxhetore-----3
- Të dhëna të përgjithshme për organizimin e dëgjimeve-----4
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në OJQ-të, të rinjët, sportistë dhe mediat ----5-6
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në me grupet e interesit (biznese, fermerë)-7-9
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik drejtorët e shfmu të Komunës së Ferizajt ----10-14
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me grupe të nënpërfaqësura (pensionistët, personat me aftësi të kufizuar etj)-----15-17
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me personeli shëndetësor QKMF, QMF të -18-20
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me komunitetin pakicë -----21-23
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me gratë -----24-26
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me kryetarët e bashkësive lokale dhe kryetarët e fshatrave të Komunës së Ferizajt -----27-29
- Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik anëtarët e Kuvendit të Komunës -----30-32
- Përfundimi-----33



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Tabelori me të dhëna të shkurtëra për dëgjime buxhetore:

Nr	Emri dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data e mbajtjes	Nr. pjesëmarrëseve	Numri i kërkesave
1	-Dëgjimi Publik OJQ-të, të rinjët, sportistë dhe mediat Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/ojq-te-te-rinjet-sportiste-dhe-mediat-paraqiten-kerkesat-e-tyre-per-projektbuxhetin-e-vitit-2025/	05.08.2024	F 9 M 7 T 16	9
2	-Dëgjimi Publik Dëgjimi buxhetor me grupet e interesit (biznese, fermerë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/fermeret-ferizajas-kane-paraqitur-nevojat-dhe-kerkesat-e-tyre/	05.08.2024	F 6 M 8 T 15	5
3	-Dëgjimi Publik me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Ferizajt -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/drejtoret-e-shkollave-paraqiten-kerkesat-dhe-nevojat-e-tyre-per-projektbuxhetin-e-vitit-2025/	06.08.2024	F 10 M 26 T 36	45
4	-Dëgjimi Publik me grupe të nënpërfaqësura (pensionistët, personat me aftësi të kufizuar etj). -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/takimet-buxhetore-jane-mbajtur-edhe-me-grupet-e-nenperfaqesura-pensionistet-si-dhe-personat-me-aftesi-te-kufizuara/	06.08.2024	F 7 M 8 T 15	2
5	-Dëgjimi Publik me personelin shëndetësor QKMF, QMF të Komunës së Ferizajt -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/kane-vazhduar-takimet-buxhetore-edhe-me-personelin-shendetesor-te-ferizajt/	07.08.2024	F 14 M 9 T 23	9



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

6	-Dëgjimi Publik në me komunitetin pakicë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/degjimet-buxhetore-jane-mbajtur-sot-edhe-me-komunitete-e-komunes-se-ferizajt/	07.08.2024	F 6	M 8	T 15	30
7	-Dëgjimi Publik me me gratë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/grate-ferizajase-paten-kerkesa-te-ndryshme-gjate-degjimit-te-sotem-buxhetor-3/	08.08.2024	F 19	M 4	T 23	8
8	-Dëgjimi buxhetor me kryetarët e bashkësive lokale dhe kryetarët e fshatrave të Komunës së Ferizajt -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/kryetaret-e-bashkesive-lokale-dhe-kryetaret-e-fshatrave-paraqiten-kerkesat-e-tyre-2/	08.08.2024	F 6	M 22	T 28	91
9	-Dëgjimi i përgjithshëm- anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo me gjerë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/news/anetaret-e-kuvendit-te-komunes-ne-degjimin-e-sotem-buxhetore-kane-paraqitur-kerkesat-e-tyre/	09.08.2024	F 8	M 7	T 15	33
			Femra----:91 Meshkuj-:106 Totali-----:197	Nr i përgjithshëm: 197		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Të dhëna të përgjithshme për organizimin e dëgjimeve:

Këto procesverbale janë përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 24.07.2024, janë publikuar dokumentet në web, platformë dhe në rrjetin social facebook.

Njoftimi në web:

<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/degjimet-publike/njoftimet-degjimet-publike/>

Njoftimi në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42546>

Njoftimi në facebook:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=888903926613399&set=pcb.888904489946676>

Me 44.07.2024:

Kalendari-Njoftimi përmes emailit u është dërguar : Drejtorëve të shkollave fillore-publike; drejtorëve të shkollave të mesme-publike; drejtorëve të shkollave private; pedagog, psikolog, mësime, mbështetës në shkollat fillore dhe të mesme; sekretarëve të shkollave të punësuar



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

në institucione arsimore; policia, zjarrfikës, biznese; OJQ për mirëqenie, OJQ për barazi gjinore; institucione shëndetësore (QKMF, QMF dhe AMF) dhe OJQ të ndryshme.

Përmes grupit të formuar në rrjetin social viber, njoftimi dhe materialet që kanë të bëjnë me dëgjime buxhetore u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve të Komunës së Ferizajt.

Procesverbal nga takimi me ojq-te, mediat dhe te rinjtë

Me datën 5 gusht 2024, është mbajtur dëgjimi i parë publik për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2025 me OJQ-të, të rinjët, sportistë dhe mediat.

Ky dëgjim buxhetor ka filluar në orën 10:00 ndërsa ka marrë pjesë Nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Lulzim Aliu, drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku, drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhemile Murati Shabani, drejtorja e Administratës së Përgjithshme Agnesa Hajredini si dhe udhëheqësja e zyrës për informim dhe komunikim me publikun Shyhrete Topalli.

Hapjen e këtij dëgjimi e ka bërë nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Lulzim Aliu, i cili ka thënë se këtë herë, po bëhen këto dëgjime në këtë mënyrë me grupe të ndryshme të interesit në mënyrë që të jenë të qarta kërkesat e të gjithë qytetarëve.

Në vitet e kalume kryesisht kemi bërë debate me qytetarë, pa ba dallime të grupit të interesit, ndërkaq këtë vit e kemi pa që më e nevojshme është që ti takojmë grupet e interesit se sa qytetarë të përcaktuar. Sot si grup të interesit e kemi caktu me OJQ-të, të rinjët, sportistë dhe mediat për të parë se çka mund të bëjë komuna për këto grupe të interesit.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në këtë dëgjim publik të pranishmit për pjesëmarrje i ka falënderuar drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku.

Pas fjalës hyrëse, fjala ju dha të pranishmëve në sallë.

Dashurije Ahmeti-

- Të krijohen mekanizma që të merren me shëndetin mendor të fëmijëve.
- Funksionalizimi i Qendrës Rinore, si dhe të krijohen sa më shumë hapësira për të rinjët.
- Të bëhet transporti publik
- Të punohet më shumë dhe të organizohen kampingje verore me të rinjët

Bashkim Haxhimusa

- Të rritet subvencionimi për klubet sportive
- Të rritete buxheti për pjesëmarrjen në olimpida
- Objekti i shkollës së fshatit Jezerc, të bëhet qendër rekreative sportive në mënyrë që të shfrytëzohet nga të rinjët

Gojarta Grainca

- Pse nuk ju kanë ndarë mjete shoqatës "Hendifer" nga projekti "Vullneti ynë"

Skender Ramadani

- Të përfshihen të gjitha shkollat në sportin veror

Daut Hoxha-Shiqata e të verbërve

- Të ndahet një buxhet i caktuar për shoqatën në mënyrë që të marrin pjesë në garat sportive, sepse kemi dy klube sportive.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Mbylljen e këtij dëgjimi buxhetor e bëri Nënkryetari Aliu.

Dëgjimi buxhetor ka përfunduar në orën 11:30.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me fermerët dhe bizneset ferizajas

Me datën 09.08.2024, është mbajtur dëgjimi publik për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2025 me fermerët dhe bizneset ferizajase.

Ky dëgjim buxhetor ka filluar në orën 14:00 ndërsa ka marrë pjesë drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku.

Në këtë takim drejtorja Ajeti-Sadiku, këta të fundit i ka njoftuar lidhur me planifikimet që po bëhen për hartimin e buxhetit të vitit 2025, duke theksuar se kjo formë e komunikimit me ta ishte më e mirë dhe më e përshtatshme.

Gjatë këtij takimi të pranishmit kanë paraqitur nevojat e tyre. Fermerët kërkuan sa më shumë subvencione, ndërsa bizneset kërkuan që në një formë të bëhet edhe subvencionimi i të gjitha bizneseve të vogla dhe të mesme në komunën e Ferizajt.

Igballe Esati

- Të bëhet subvencionimi për shitjen e qumështit për litër ashtu siç e kane bë Komuna e Lipjanit .

Ganimete Jusufi:



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- A ka mundësi një sere të madhe për afro 5 ari tokë, gjithashtu të sigurohet edhe një grumbulluese.

Behrije Nuha;

- Të bëhet një kioskë për shitjen e produkteve dy here ne jave.

Xhelal Topalli;

- Të bëhet financimi me nafte.

Luljeta Imeri;

- Të na ndihmoni me një kosë për pemëtari.

Ky dëgjim publik ka përfunduar në orën 15:30.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me Kryetarët e bashkësive lokale dhe kryetarët e fshatrave të Komunës së Ferizajt

Me datën 08.08.2024 është mbajtur dëgjimi buxhetor për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2025 me Kryetarët e bashkësive lokale dhe kryetarët e fshatrave të Komunës së Ferizajt.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ky takim ka filluar në orën 14:15.

Hapjen e këtij takimi e ka bërë drejtorja e financave Sebahate Ajeti-Sadiku si dhe Shyhyrete Topalli-udhëheqëse e zyrës për informim dhe komunikim me publikun.

Pas hapjes së këtij takimi fjalën drejtorja e financave e kaloi tek kryetaret e fshatrave dhe bashkësive lokale.

Sadik Qerimi-Koshare

- Të bëhet rrethoja e shkollës,
- Të bëhet një rrethotullim, trotuaret
- Të bëhet një park
- Të bëhet një çerdhe për fëmijë
- Mirëmbajtja e varrezave të fshatit
- Të bëhet ujitja e pjesvë të gjelberta

Abdurrahim Haxhiedma-Manatirc

- Të bëhet rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në fshat
- Të bëhet ndërtimi i shkollës së re të fshatit
- Të bëhet asfaltimi i rrugicave të mbetura
- Të vendosen pengesa në rrugë aty ku duhet, dhe të mos vendosen ato vend e pa vend
- Të bëhet rregullimi i rrjetit të energjisë elektrike
- Të bëhet rregullimi i rrugëve të arave
- Të bëhet një kënd i lojërave për fëmijë
- Të bëhet një fushë sportive



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Fehmi Osmani-Sazli

- Të bëhet ndriçimi publik në hyrje të fshatit
- Të bëhet rregullimi trotuareve
- Të bëhet ndërtimi i një shkolle të re
- Të bëhet rregullimi lumit në fshat
- Të bëhet ndërtimi i stadionit i cili ka mbet në gjysmë
- Të bëhet asfaltimi i rrugicave të mbetura

Shaban Uksmajli-Zona e parë e qytetit

- Të bëhet vendosja e pengesave në rrugën "Epopëja e Jezercit"
- Të bëhet pastrimi i lumit nga "Ura e Islamit" deri tek "Ura e Dudit"
- Të bëhet ndriçimi i rrugës "Arsim Bega"
- Të bëhet asfaltimi i rrugës "Zef Jubani" dhe "Ramush Shatrolli"
- Të bëhet një minipark në rrugën "Sejdi Sejdiu"

Fadil Lipovica-Softaj

- Të bëhet rregullimi i rrugës kryesore prej shkollës
- Të bëhen trotuaret
- Të bëhet një fushë sportive
- Ndricimi publik në fshat
- Rregullimi i rrugëve të arave
- Rregullimi i oborrit të shkollës

Besim Ahmeti -Greme

- Të bëhet pastrimi i nënkalimit sepse është i mbushur me ujë
- Të bëhet mirëmbajtja e ujësjellësit



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të vendosen vend ndaljet për autobusë
- Të bëhet rregullimi i rrugëve dhe rrugicave të mbetura në gjysmë
- Të bëhen rregullimi i rrugëve të arave
- Të bëhet rregullimi i trotuareve
- Të bëhet ndriçimi publik

Astrit Rexhepi-Muhovc

- Të bëhet një rrethrotullim tek tregu i kafshëve
- Të bëhet diçka konkrete edhe për shkollën e cila është në gjendje shumë të keqe
- Të bëhet asfaltimi i rrugëve të mbetura
- Të bëhen trotuaret në fshat dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese
- Të bëhet rregullimi i rrugëve të arave

Njazi Rexhepi-Slivove

- Të bëhet rregullimi i rrugës "Nezir Behluli: që lidh fshatin Dremjak dhe Jezerc
- Të bëhet rregullimi i rrugës "Bekim Jahiri", rruga "Fadil Musliu", rruga "Diaspora" dhe "Proni i vogël".
- Të bëhet një shkollë e re në fshat
- Të bëhet një park për fëmijë

Njazi Behluli

- Të bëhet diçka konkrete për ujësjellësin e fshatit
- Të bëhet ndriçimi publik
- Të bëhet pastrimi i lumit në fshat
- Të bëhet ndriçimi të parku

Zymer Berisha-Mirosale

- Të bëhet diçka për shkollën e fshatit se ka rrezik shumë të madh, se është shumë e vjetër
- Të bëhet kanalizimi në fshat në lagjet ku mungon



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet asfaltimi i rrugicave të fshatit
- Ujësjetësi i fshatit nuk po funksionon

Ali Maliqi-Rahovicë

- Të bëhet rregullimi i rrugicave të fshatit
- Të bëhet një park në fshat
- Të bëhet rregullimi i oborrit të shkollës
- Të bëhet ndriçimi publik në fshat
- Të bëhet rregullimi i rrugës kryesore

Bedri Aliu-Neredime e Ulët

- Të bëhet zgjerimi dhe rregullimi i rrugës nga fshati Manastriç
- Të bëhen 130 km kanalizim i cili ka mbetur pa u përfunduar
- 62 rrugica janë të paasfaltuara
- Të bëhet rregullimi i ujë matësve
- Të bëhet një kënd i lojërave për fëmijë

Haki Veseli-Komogllavë-Gurëz

- Tek shkolla në fshatin Komogllavë të bëhet një vend parking
- Të bëhet ndriçimi publik në Komogllavë dhe Gurëz
- Të bëhet lirim i rrjetit të kanalizimit tek depo "Dauti Komerc"
- Të bëhet ujësjetësi në fshat

Taip Bytyqi-Mirash

- Të bëhet diçka konkrete për ujë të pijshëm, por edhe për keqpërdoruesit e ujit
- Të bëhet pastrimi nga mbeturinat
- Të bëhet asfaltimi i rrugës Mirash-Softaj



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet asfaltimi i rrugës babush-Mirash
- Të bëhet ndriçimi publik
- Asfaltimi i rrugës për te "Kroni i Bujanit"
- Të bëhet rregullimi i rrugëve të arave
- Të bëhet vendosja e pengesave në rrugë
- Të bëhen dy parqe në lagjen e "Xhamisë" dhe në rrugën e "Hashanëve"
- Të bëhet largimi i një shtylle elektrike në mes të rrugës
- Të bëhet një fushë sportive dhe sallë të edukatës fizike

Agon Zhinipotoku -Cërrnillë

- Të bëhet asfaltimi i rrugës kryesore të fshatit

Sabedin Mustafa-Pleshinë

- Të bëhet pastrimi i lumit të fshatit
- Të bëhet një fushë sportive
- Të bëhet heqja e mbeturinave të ngurta
- Të bëhet heqja e mbeturinave të ngurta
- Të bëhet një çerdhe në fshat

Njazi Cakolli -Zaskok

- Të bëhet asfaltimi i rrugicave të fshatit



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet një fushë sportive
- Të bëhet rrethoja e oborrit të shkollës
- Të bëhet asfaltimi i rrugës për në fshatin Doganaj

Ky dëgjim buxhetor ka përfunduar në orën 16:00.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Ferizajt

Me datën 06.08.2024, është mbajtur dëgjimi i tretë publik për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2025 me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Ferizajt. Ky takim ka filluar në orën 10:15.

Në këtë dëgjim publik ka marrë pjesë drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku si dhe Shyhrete Topalli nga zyra për komunikim me publikun.

Hapjen e këtij dëgjimi e ka bërë drejtorja e financave Sebahate Ajeti-Sadiku e cili ka thënë se këtë vit po bëhen dëgjimët në mënyrë me grupe të ndryshme të interesit në mënyrë që të jenë të qarta kërkesat e të gjithë qytetarëve.

Pas fjalës së drejtores, fjala ju është dhënë të pranishmëve në sallë.

Abaz Asllani-drejtor i Shfmu "Ganimete Tërbeshi"

- Të bëhet instalimi i rrjetit të internetit në shkollë.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ymri Hashani- Shfmu "Ali Hadri" Mirash

- A do të bëhet aneksi i shkollës në fshat, në mënyre që procesi mësimor të zhvillohet me një ndërrim.

Ismet Balaj-Shfmu "Abetarja" Softaj

- Të bëhet një sallë sportive sepse kemi hapësire të mjaftueshme për ndërtimin e saj.

Zekir Burrniku-Shfmu "Dardania" Rakaj

- Të bëhet renovimi i objektit shkollor, por të bëhet edhe një anekse shtesë i shkollës.
- Të bëhet edhe rregullimi i një salle sportive

Raif Ibrahim-Shfmu Tërrn

- Të bëhet rregullimi i oborrit të shkollës
- Të bëhet një fushe sportive
- Të krijohen mundësitë që procesi mësimor të zhvillohet me një ndërrim

Kujtim Ilazi- Shfmu "Besim Rexhepi"

- Të bëhet një ankese shkollor në shkollën e fshatit në lagjen Llugaj si dhe të bëhet rregullimi i tualeteve
- Të bëhet rregullimi i oxhakut të shkollës

Sylejman Haxhaj- shfmu "Mic Sokoli" Slivovë

- Të bëhet rregullimi i oborrit të shkollës



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet rregullimi i rrjetit të internetit
- Të bëhet meremetimi i një terase të shkollës, sepse prej saj ka filluar të shkatërrohet e gjithë shkolla/

Bekim Ndrecaj shfmu "Naim Frashëri" Zaskok

- Të krijohet një hapësire në oborrin e shkollës dhe të rregullohet
- Të bëhet izolimi i shkollës në fshatin Doganaj

Arigona Marevci- shfmu "Afrim Abazi"

- Të bëhet rregullimi i një salle sportive
- Të bëhet kabinetet të informatikës si dhe të vendosen tabelat dixhitale

Ganimete Konjufca-shfmu "Ahmet Hoxha"

- Të bëhet ndarja e buxhetit për secilën shkollë
- Të ketë buxhet të veçante për nxënësit me nevoja të veçanta
- Të ketë mëditje për punëtorët arsimor, kryesisht për ata që merren më fëmijët me nevoja të veçanta

Shyqeri Halili-shfmu "Dituria" Dardani

- Të bëhet një sallë sportive
- Të bëhet rregullimi i tualeteve
- Të krijohet një kabinet për nxënësit e shkollës
- Të krijohet një parking për veturat
- Të bëhet një anekse shtesë i shkollës në mënyrë që procesi mësimor të zhvillohet më një ndërrim



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet një mbikalim për shkak të rrezikut të madh të rrugës kryesore.

Refik Palloshka-shfmu "5 dëshmorët" Pleshinë

- Të bëhet një anekse shkollore për mësim me vetëm një ndërrim
- Të bëhet një fushë sportive me bari sintetik

Kushtrim Avdiu- shfmu "Hajriz Muhadini" Dremjak

- Të bëhet nivelizimi i oborrit të shkollës
- Të rregullohen nyjet sanitare në tualetet e shkollës
- Të bëhen tableta dixhitale në shkollë

Liman Zagerxha

- Të bëhet rregullimi i dyshimeve në shkollë

Ibrahim Sallahu- shfmu '4 Prilli' Zllatar

- Të bëhet ndërrimi i dritareve
- Të bëhet izolimi i jastëm i shkollës
- Të bëhet renovimi i shkollës në katin e dytë

Mervete Ramiqi-shfmu Manastric

- Të bëhet ndërtimi i shkollës së re

Shpresa Ibrahim- shfmu "Astrit Bytyqi"

- Të bëhet diçka konkrete tek tualetet e shkollës



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Adnan Hashani-Gjimnazi "Kuvendi i Arbërit"

- Të këtë një sallë teatrale në shkollë
- Të këtë kabinet dhe dixhitalizim të shkollave

Afërdita Beqa -shfmu "Dëshmorët e Kosharës" Koshare

- Të këtë më shumë mjete konkretizimi për kabinetet ekzistuese
- Të bëhet rregullimi i qatisë së shkollës
- Të bëhet furnizimi me libra të rinjë në bibliotekën e shkollës
- Të bëhet rregullimi i oxhakut të nxemjës në shkollë

Heset Vranovci- Shkolla e Agobiznesit " Zenel Hajdini"

- Të bëhet një drenazhim i shkollës
- Të bëhet rregullimi i qatisë së shkollës tek pjesa e kulmit.

Ky dëgjim buxhetor ka përfunduar në orën 12:00.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo me gjerë

Me datën 09.08.2024 është mbajtur dëgjimi buxhetor me anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo me gjerë. Ky dëgjim buxhetor ka filluar në orën 10:00.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Hapjen e këtij dëgjimi buxhetore e ka bërë drejtorja e Financave Sebahate Ajeti- Sadiku, e cila i ka njoftuar të pranishmit në mënyrë të detajuar për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Pjesë e këtij takimi ishte edhe Shyhrete Topalli udhëheqëse e zyrës për informim dhe komunikim me publikun.

Pas hapjes së këtij takimi drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku, fjalën për të paraqitur kërkesat e tyre.

Gëzim Haxhimusa

- Të ndihmohen familjet që kanë persona me nevoja të veçanta, kryesisht fëmijët e tyre edhe në shkollim.
- Të bëhet rrethoja e shkollës në fshatin Doganaj
- Të bëhet izolimi i shkollës
- Të bëhet asfaltimi para objektit ku shërben për të pame në fshatin Doganaj
- Trotuari në Doganaj

Arbnora Salihu

- Të krijohet një platformë online për qytetarët, qoftë në formatin e aplikacionit për telefon apo uebsite, e cila do të ua mundëson qytetarëve të raportojnë probleme që i hasin në qytet, të ndjekin zhvillimin e projekteve dhe të japin ide për përmirësime. Kjo do të ndikonte shumë në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës ;
- Kërkesa e dytë kishte të bëjë me transportin publik për fshatin Balaj. Pavarësisht që fshati Balaj është ndër fshatrat më të vogël, banorëve të cilët banojnë në pjesën e fundit të fshatit, iu duhet të ecin rreth një kilometër për të marrë autobusin apo taksinë për në qytet. Në ditët e nxehta apo gjatë stinës së dimrit, shtu këtu edhe qentë endacak, ecja deri tek vendi i pritjes është shqetësim i madh për nxënësit, personat në moshë dhe për pjesën tjetër të banorëve. Banorët po kërkojnë që autobusi të hyjë brenda në fshat deri tek rrethi afër shkollës së fshatit. Kërkova



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

nga drejtoria përkatëse që të merret seriozisht me këtë çështje dhe të ndërmarr hapat e duhur për të aprovuar këtë kërkesë ;

- Kërkesa e tretë është kërkesë që vjen nga banorët e fshatit Nikadin, me saktësisht banorët e lagjes Berisha, afër varrezave. Banorët kanë kërkuar që në atë zonë të ndërtohet një park apo fushë sportive. Për momentin hapësira është e pashfrytëzueshme ndërsa në të kaluarën ka qenë fushë futbollit dhe basketbollit ;
- Kërkesa e katërt ishte për rregullimin e ashensorit tek banesat e solidaritetit, në të cilat janë të sistemuara kategoritë e dala nga lufta, shqetësimi i komunitetit është shumë i madh për arsye se ashensori ka punuar vetëm dy muaj dhe tashmë ka mbi 10 vite që nuk punon. Unë kërkoja nga drejtoria përkatëse që të merret urgjentisht me këtë kërkesë dhe të rregullohet ky problem ;
- Gjithashtu, kërkoja që të rritet siguria në parkun "Liria", qoftë me persona fizik apo kontrolla të rregullta, e gjithashtu të bëhet mbulim më i madh i hapësirës me ndriçim ;
- Për rritje të vigjilencës dhe kujdesit kërkoja që të vendosen kamera të sigurisë së paku në rrugët kryesore të qytetit . Gjithashtu, për rritje të sigurisë kërkoja që të shtohet numri i vendkalimeve për këmbësor të pajisura me sinjalistikë dhe ndriçim poashtu me shirita/ pengesa për ndalje para vendkalimit për këmbësor ;
- Të bëhet ri-ngjyrosja e shtigjeve të biçikletave, rruga Brahim Ademi, Ferizaj-Shtime ;
- Funkcionalizim i ËC-ve publike në nënkalim, pse jo edhe ndërtim i tyre në zona të tjera të qytetit ku shihet si e nevojshme ;
- Shtim i kapacitetit rekreativ tek salla e sporteve "Bill Clinton" - Të ndërtohet një fitnes jashtëm (outdoor gym), të ketë edhe lojra për fëmijë sepse



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

frekuentohet shumë edhe nga familjar dhe të mirëmbahen fushat jashtme të tenisit dhe pingpongut, por edhe hapsira në përgjithësi ;

- Të mundësohet transport publik për nxënësit e fshatit Terrn dhe rrethinës ;
- Të krijohet një hapësire/kënd i veçantë për të rinjtë ferizajas tek qendra e rinisë, të cilët do të kishin qasje në pajisje elektronike, ku do të mund ta kalonin kohën e lirë duke studiuar dhe shfrytëzuar pajisjet gjatë qëndrimit aty ;
- Mbështetje më e madhe për klubet sportive private ferizajase të cilat e përfaqësojnë qytetin tonë dhe Kosovën nëpër botë dhe marrin çmime, p.sh: gjimnastikë, karate dhe sporte të tjera
- Të ndahet fond i veçante për pajisjen e kabineteve me pajisjet e nevojshme dhe gjithashtu mirëmbajtjen e higjienës nëpër shkolla .
- TË bëhet edhe zgjerimi i rrugës "Rizah Bllaca", sepse është shumë e ngushtë.

Mimoza Sojeva-Pajaziti

- Të bëhet renovimi i sallës së kuvendit të komunës
- Ndriçimi publik në Sojeve
- Zgjerimi i hapësirës, për tek shkollë "Ganimete Tërbeshi"
- Të bëhet rregullimi i pusetave në qytet
- Të bëhet diçka konkrete edhe tek hapësirat e gjelbërta të ketë pajisje sportive dhe rekreacion
- Shkollat të pajisjen me kompjuter dhe kabinete

Arian Imeri

- Të bëhet ngjyrosja e ndërtesave të vjetra në qytet

Elbasan Osmani



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARLJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet një rrethrotullim në rrugën "Brahim Ademi"
- Rrugica të reja të bëhen në fshatin Jezerc, aty ku kanë mbet
- Të bëhet krijimi i parqeve të reja në qytet
- Të bëhet pyllëzimi në vendet e caktuara
- Për fëmijët parashkollor të financohet një kombibus për fëmijët me nevoja të veçanta
- Të vazhdohet me financimin e të rinjëve me start-up.

Ejup Delolli

- Të bëhet diçka konkrete në lidhje me kanalizimin i cili ka dështuar që disa herë për fshatin Dubravë dhe Zaskok.

Këtë dëgjim buxhetor e përfundoi drejtorja e financave Sebahate Ajeti-Sadiku.

Ky takim ka përfunduar në orën 11:40.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me gratë nga Ferizaj

Me datën 08.08.2024, është mbajtur dëgjimi buxhetor vetëm me gratë e qytetit të Ferizajt. Ky dëgjim buxhetor ka filluar në orën 10:00.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Hapjen e këtij dëgjimi buxhetor e ka bërë drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku, bashkë me udhëheqësen e zyrës për informim dhe komunikim me publikun Shyhrete Topalli.

Në hapjen e dëgjimit buxhetor drejtorja Ajeti ka thënë se ky takim është organizuar enkas vetëm me gratë, në mënyrë që të dihen sakte prioritete e tyre.

Gratë e pranishme në këtë takim, patën një numër të pakët të kërkesave.

Diellza Reka

- Të bëhet një park dhe lodra për fëmijë në fshatin Neredime te Eperme.

Vlora Aliu

- Kur pritet të bëhet funksionalizimi i çerdhes në fshatin Greme

Nazmije Ademi

- A ka mundësi në fshatin Dardani, të vendosën më shumë shporta të mbeturinave në këtë fshat, si dhe të bëhet diçka konkrete sa i përket qenve endacak në këtë fshat për shkak të rrezikut shumë të madh të tyre.

Hamide Ilazi-Prelez i Jerlive

- Të sigurohet një kombi bus për bartjen e fëmijëve të këtij fshati për në shkollë, për shkak të rrezikut të madh nga qenët endacak.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Erza Vladi

- Të bëhet ndriçimi publik në rrugën "Arsim Bega"
- Të bëhet transporti publik në zonën e parë të qytetit për shkak se në planifikimet e juaja nuk është vendosur.

Hidajete Bytyqi

- Një makinë për vjelljen e mjaltëse, si dhe nëse keni mundësi edhe disa koshere të bletëve të më jepni në vitin 2025.

Igballe Esati

- Të bëhet rregullimi i rrugës në fshatin Pojatë si dhe ndriçimi publik.

Mbylljen e këtij dëgjimi buxhetor e bëri drejtorja Sebahate Ajeti-Sadiku

Ky takim përfundoi në orën 11:20.

**Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësura
(pensionistët, personat me aftësi të kufizuar etj)**



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Me datën 06.08.2024, është mbajtur dëgjimi i katërt publik për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2025 me grupe të nënpërfaqësura (pensionistët, personat me aftësi të kufizuar etj).

Ky takim ka filluar në orën 14:15.

Në hapjen e këtij takimi ka marrë pjesë drejtoresha e financave Sebahate Ajeti-Sadiku, por edhe drejtori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale Dr. Kemajl Emini si dhe udhëheqësja e zyrës për informim dhe komunikim me publikun Shyhrete Topalli.

Pas informacioneve të duhura në lidhje me subvencionimin e kësaj kategorie, fjala ju është kaluar në pranishmeve në sallë.

Enver Kosumi- Handikos

- A ka mundësi që buxheti të ndahet vetëm për shërbimet sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale?

Daut Hoxha- Shoqata e të verbërve

- Pse shumë organizata po lihen anash gjatë thirrjeve publike që po bëhen dhe nuk po financohen?

Gojarta Grainca- Hendifer

- Çka po ndodh me një kombi që e kemi pas si shoqate dhe nuk po bëhet rregullimi i tij nga ana e kompanisë që është fituese e tenderit nga komuna?

Gresa Behluli-Donw sindrom

- Të bëhet sigurimi i një objekti për shoqatën tonë.



Ky takim ka përfunduar në orën 15:15.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me komunitetin pakicë në Ferizaj

Me datën 07.08.2024 është mbajtur dëgjimi i gjashtë buxhetor me komunitetin pakicë të komunës së Ferizajt. Ky dëgjim buxhetor ka filluar në orën 14:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Në këtë dëgjim buxhetor ka marrë pjesë drejtorja e financave Sebahate Ajeti-Sadiku si dhe Shyhrete Topalli udhëheqëse e zyrës për informim dhe komunikim me publikun.

Hapjen e këtij dëgjimi publik e ka bërë drejtorja Sebahate Ajeti-Sadiku. Ajo të pranishmit i ka njoftuar për procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2025, ndërkaq ka kërkuar nga këta të fundit, që të paraqesin të gjitha kërkesat, por edhe problemet me të cilat ballafaqohen.

Komunitetet e pranishëm në këtë takim, kanë kërkuar që të bëhet diçka konkrete për përmirësimin e jetës së tyre, duke kërkuar kështu ndërtim të shtëpive, pagesa të qirave, por kanë kërkuar që të bëhen edhe më shumë fushata sensibilizuese për shkollimin e komunitetit pakicë në Komunën e Ferizaj.

Muzafer Ramadani

- Në rrugën "At Nikë Prela" të vendosen kamerat dhe pengesat në rrugë
- Të merren mbeturinat me kohë dhe të bëhet pastrimi i rrugës për shkak të rrjedhës së kamionit.
- Të bëhet asfaltimi i rrugës Remzi Mustafa" dhe "Mujë Maliqi"

Rexhep Bajrami



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet asfaltimi i rrugës së dëmtuara "Ejup Statovic" nga farkatari gjer të rruga që lidh fhstain Doganaj dhe Dubrave gjithashtu gjatë asfaltimit të vendosen edhe pengesa në rrugë
- Të bëhet rregullimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën "Sali Sh. Berisha"
- Të bëhet rregullimi i rrjetit të kanalizimit në rrugë "Selman Berisha"
- Të bëhet ndërrimi i gypave të kanalizimit në rrugën "Xhemal Kada"
- Të bëhet vendosja e një trafo nga Kedsi në rrugën "15 shkurti" Sallahane
- Të bëhet asfalyimi i rrugës "Ruzhdi Ajeti"
- Rruga "Rexhe Maliqi" të bëhet me ndriqim publik
- Të bëhet ndërrimi i shtyllave të drunjëve ne të betonit
- Të bëhet përmirësimi i rrjetit elektrik në disa vende pasi që kabllot janë rënë poshtë dhe ka rrezik për të gjithë
- Të bëhet vendosja e një pasqyrë përballa farkatrait dhe në hyrje të rrugës "15" shkurti
- Të bëhet nivelizimi i rrugës më kubeza "Asim Voshi" si dhe rregullimi i pusetave.

Ne lagjen "Halit Ibishi" të bëhen këto investime:

- Asfaltimi i rrugicës "Remzi Mustafa" 40 metra
- 'Asfaltimi i rrugicës "Hajrush e Mujë Maliqi 25 m(r.Gjilanit)
- Vendosja e një shtylle elektrike dhe një drite të ndriçimit publik në rrugën "Remzi Mustafa"
- Vendosja e pengesave në rrugën "At Nik Prela"

Në fshatin Dubrave të bëhen këto investime:

- Asfaltimi i rrugës te Selajtin Dudaki 35 metra
- Asfaltimi i rrugës "Elmi Hasani" 30 m
- Asfaltimi i rrugës "Nexhat Hasani" 30 m
- Asfaltimi i rrugës "Hajriz Hajrizi" 40 m.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Hapja e pusetës së mbyllur te Qendra Edukative Sociale

-Vendosja e pasqyrave përball tek rruga e fshatit Dubrave e cila lidh rrugën kryesore për fshatin Pleshinë si dhe në rruga në hyrje të shkolla "Naim Frashri e cila kryqëzohet me fshatrat Zaskok, Manastric, Pleshinë dhe Dubrave.

- Të vendoset një trafo e re te varrezat e reja "vendi i kodrave" në Dubrave ku pritet të ndërtohen 47 shtëpi.

Mehmet Jashari

- Të ndahen mjete shtese për ndërtimin e shtëpive për familjet që kanë nevojë.

Fadil Bajrami

- Të bëhet rregullimi i rrugës "Ejup Stataovci"

Spasenka Maliqi

- Nëse ka mundësi të më ndihmoni në ndërtimin e shtëpisë, sepse jetoj në kushte shumë të rënda me familjen time 9 anëtarshë në një dhomë gjumi.

Osman Emini

- Të bëhet sinjalizimi në afërsi të shkollave sidomos fillore se aty afër ka shkollë, po ashtu edhe në rrugicat që janë të shkolla të ketë policë të shtrire.
- Të ndahet një buxhet për kryerjen e aktiviteteve vetëdisuese dhe ofrim të informatave për komunitetin siç është: çështja e arsimit, siguria, dukuritë negative, por edhe të drejtat e njeriut.

Ky takim ka përfunduar në orën 15:30.



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me personeli shëndetësor të QKMF-së dhe QMF-ve të Komunës së Ferizajt

Me datën 07.08.2024, është mbajtur dëgjimi i pestë publik për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2025 me personeli shëndetësor të QKMF-së dhe QMF-ve të Komunës së Ferizajt.

Ky takim ka filluar në orën 10:00.

Në hapjen e këtij takimi drejtorja e financave Sebahate Ajeti-Sadiku ka thënë se këtë takim e kanë thirrur për të parë nga afër nevojat dhe kërkesat, por edhe problemet më të cilat ballafaqohen stafi shëndetësor i komunës së Ferizajt.

Pjesë e këtij takimi ishte edhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Dr. Kemajl Emini, si dhe Shyhrete Topalli udhëheqëse e zyrës për informim dhe komunikim me publikun.

Me këtë rast drejtorja Ajeti-Sadiku, stafin shëndetësor e ka njoftuar për projektet që pritet të realizohen në fushë e shëndetësisë për vitin e ardhshëm. Pas kësaj fjalën jau kaloi stafit shëndetësor për të paraqitur kërkesat e tyre.

Të pranishmit në sallë i ka përshëndetur edhe drejtori Dr. Kemajl Emini.

Nadire Imeri-Drejtoreshë e QKMF-së

- Të ndahen 100 mijë euro për inventarizimin e objektit të ri të QKMF-së e cila është në ndërtim e sipër.

Selim Bega

- Të rritet numri me stafin e infermiereve



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Avni Neziri

- Të bëhet rregullimi i oborrit dhe hyrja e QKMF-së 4.
- Të bëhet largimi i kompanisë "Pastërtia"

Muhamet Ahmeti

- Të sigurohet staf i ri për QMF-të për shkak se shumica jemi afër pensionimit, por të sigurohet edhe staf me infermierë.

Driton Hyseni

- Të sigurohen edhe 10 karriga të reja stomatologjike si dhe të sigurohet edhe aparati autklar për sterilizimin e pajisjeve
- Të sigurohen kompjuter dhe printer për mjekët stomatologë

Ganimete Nazifi-Islami

- A mund të bëni zgjerimin e analizave laboratorikë në laboratorët e Qendrave të Mjekësisë Familjare.

Besim Ademi

- A mund të bëni rregullimin e njeve sanitare të QKMF 1?
-

Ky takim ka përfunduar në orën 11:30 .



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Përfundimi:

Komuna jonë me kohë dhe brenda afateve ligjore ka formuar grupin punues për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2025-2027 si dhe Projekt Buxhetin e Komunës së Ferizajt për vitin 2025, poashtu kemi hartuar me kujdes të shtuar kalendarin shtrirjen horizontale të dëgjimeve buxhetore në teritorin e komunës së Ferizajt.

Kemi planifikuar t'i organizojmë 10 dëgjime buxhetore dhe të gjitha janë organizuar sipas objektivave të planifikuara, pjesë marrja e qytetarëve në dëgjime ka qenë relativisht e kënaqshme, ne si komision kemi analizuar përmes sistemit të swot analizës, realizimin e dëgjimeve buxhetore dhe kemi pranuar kthim informacion për nevojat, që viteve në vijim dëgjimet buxhetore të organizohen sa më mirë dhe më pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve të komunës sonë.

Për të gjitha dëgjimet kemi ruajtur kujdesin që të hartojmë procesverbalet me kërkesat e bëra nga ana e qytetarëve të pranishëm në dëgjim dhe në fund fare kemi hartuar edhe raportin final me të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe ne si komunë u jemi përgjigjur në formë të shkruar në raport pranimit të kërkesave, refuzimit ose të pranuar pjesërisht.

Procesmbajtës:

Shyhrete Topalli



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.